

NPL



**Kastrioti Sh.A**  
**Obiliq**

## NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

**Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale  
për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023**

Kompania: NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Adresa: Rruga Vashingtoni P/N,

Qyteti: Obiliq

NUI: 811838509

## DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË

Sipas njohurive tona, ky raport nuk përmban deklarime materiale të pasakta dhe nuk ka lëshime materiale të cilat kanë për qëllim orientimin e gabuar të shfrytëzuesëve të raportit.

Sipas njohurive tona, pasqyrat financiare dhe dokumentet tjera të prezantuara në këtë raport prezantojnë në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare, rezultatet e operimit dhe rrjedhën e parasë për periudhën e prezentuar në raport.

Ne jemi përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara nga menaxhmenti/bordi i kompanisë.

Kjo përgjegjësi përfshinë: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimet apo pasaktësitë, përzgjedhja dhe aplikimi i politikave të duhura kontabël dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me natyrën e operimit të kompanisë.


Në baza të rregullta ne bëjmë vlerësimin e këtyre politikave për ta përcaktuar nevojën që kontrollet të shtohen apo të bëhet revidim i kontrollave të brendshme të atilla që sigurojnë mbrojtjen e pasurisë së kompanisë.

**Berat Mehmeti**



**Drejtor Ekzekutiv**

**Arbnora Zeqiri**



**Menaxhere e Financave**

prill, 2024

## PËRMBAJTJA

## FAQE

RAPORTI I AUDITORIT	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	7
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	8
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	9
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	10
SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE	11-20

## **RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

### **Drejtuar menaxhmentit të NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A**

#### ***Opinion***

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF).

#### ***Baza për Opinion***

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

#### ***Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative***

##### ***Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit***

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative ne kemi marrë parasysh nëse ai përfshinë shpalosjet e kërkuara nga neni 7 i Ligjit 06/L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin.

Sipas opinionit tonë:

- Informacioni i shpalosur në raportin e menaxhmentit për vitin financiar për të cilin janë përgaditur pasqyrat financiare, është konsistent, në të gjitha aspektet materiale me

informacionin në pasqyrat financiare dhe përgatitet në përputhje me kërkesat e nenit 7 të Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

- Deklarata e qeverisjes korporative është përgaditur në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe është konsistent me informacionin në pasqyrat financiare.

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Kompaninë, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruarat të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse

arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dh përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

### **Raport për kërkesat e tjera ligjore dhe kërkesat rregullatore**

Ne konfirmojmë se nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-auditimi të specifikuara në nenin 5 të udhëzimit asministrativ nr.02/2019 dhe kemi qenë t pavarur nga kompania në kryerjen e auditimit.



Besa Berisha – Auditore Ligjore  
ECOVIS UA Kosova Sh.p.k.  
Q.T.Bregu i Diellit nr. 26, Prishtina  
Tel.+38344124898



29.04.2024

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Pasqyra e pozicionit financiar****Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
<b>PASURITË</b>	<b>Shënime</b>		
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	1	106,933	65,984
Llogaritë e arkëtueshme	2	37,921	14,250
<b>Totali i pasurive qarkulluese</b>		<b>144,854</b>	<b>80,234</b>
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
<b>Totali i pasurive jo-qarkulluese</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>TOTALI I PASURIVE</b>		<b>144,854</b>	<b>80,234</b>
<b>EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkurta</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	3	42,420	-
Obligimet tatimore	4	44,653	30,865
<b>Totali i detyrimeve afatshkurta</b>		<b>87,073</b>	<b>30,865</b>
<b>Ekuiteti Aksionar dhe Rezervat</b>			
Kapitali aksionar		10,000	10,000
Fitimet/Humbjet e bartura		39,369	-
Fitimi apo Humbja e vititi financiar		8,411	39,369
<b>Totali i Ekuitetit Aksionar dhe i Rezervave</b>		<b>57,780</b>	<b>49,369</b>
<b>TOTALI I EKUITETIT AKSIONAR, I REZERVAVE DHE I DETYRIMEVE</b>		<b>144,854</b>	<b>80,234</b>

Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 29 mars 2024 nga:

**Berat Mehmeti****Drejtor Ekzekutiv****Arbnora Zeqiri****Menaxhere e Financave****Armend Osaj****Kontabilist i Çertifikuar**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 26 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A**  
**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse**  
**Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Shënime	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat	7	459,464	248,671
Kostoja e mallit të shitur	8	44,748	3,052
<b>Fitimi bruto</b>		<b>414,717</b>	<b>245,619</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e personelit	9	355,523	200,751
Shpenzimet administrative	10	48,876	1,401
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>404,400</b>	<b>202,152</b>
Të ardhura tjera		-	340
Shpenzimet tjera		874	56
<b>Fitimi/ Humbja operative</b>		<b>9,443</b>	<b>43,750</b>
Tatimi në fitim	11	1,032	4,381
<b>Fitimi/Humbja Neto</b>		<b>8,411</b>	<b>39,369</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 17 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet****Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	<b>Kapitali Aksionar</b>	<b>Fitimi/ Humbja e bartur</b>	<b>Totali i Ekuitetit</b>
<b>Bilanci me 01 Janar 2022</b>	<b>10,000</b>	-	<b>10,000</b>
Fitimi/humbja e vitit	-	39,369	39,369
Terheqje e dividendes	-	-	-
<b>Bilanci me 31 Dhjetor 2022</b>	<b>10,000</b>	<b>39,369</b>	<b>49,369</b>
<b>Bilanci me 01 Janar 2023</b>	<b>10,000</b>	<b>39,369</b>	<b>49,369</b>
Fitimi/humbja e vitit	-	8,411	8,411
Terheqje e dividendes	-	-	-
<b>Bilanci me 31 Dhjetor 2023</b>	<b>10,000</b>	<b>47,780</b>	<b>57,780</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 17 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Pasqyra e rrjedhës së parasë****Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në vlerën EUR)

	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2023</b>	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2022</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese</b>		
Fitimi/Humbja në fillim	8,411	39,369
Rregulluar për:		
Zhvlerësimin		
Ndryshimet në llogaritë e arkëtueshme	(23,671)	(14,250)
Ndryshimet në llogaritë e pagueshme	56,080	18,427
Ndryshimet në obligimet tatimore	129	11,334
	<b>40,949</b>	<b>54,880</b>
<b>Paratë e gjeneruara nga operacionet</b>		
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
<b>Paraja neto e përdorur në investime</b>	-	-
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Pagesat e parasë për huat dhe huazimet tjera	-	-
<b>Paraja neto e përdorur për aktivitetet financuese</b>	-	-
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent</b>	<b>40,950</b>	<b>54,880</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	65,984	11,104
<b>Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor</b>	<b>106,933</b>	<b>65,984</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 17 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

# NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

## Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

---

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

### 1. INFORMATAT GJENERALE

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A është e regjistruar si shoqëri aksionare në korrik të vitit 2021, me numër biznesi 811838509 dhe me adresë në Obiliq, Rruga Vashingtoni, P.n., operon në treg tash e tri vite.

Veprimtari primare ka Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve (mjedisit), ndërsa si veprimtari tjera janë aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave, objeteve industriale, aktivitetet e tjera të pastrimit, demolimi i objekteve, përgatitja e vendpunishtes, instalime elektrike, punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit, punime suvatimi, aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor, kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare, kultivimi i bimë vetë tjera shumëvjeçare marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve bujqësore, aktivitetet përkrahëse të objekteve të kombinuara.

# NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

### 2.1. Baza e përgaditjes

#### 2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

#### 2.1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për kompaninë janë përgaditur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

#### 2.1.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e kompanisë si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

#### 2.1.4. Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

#### 2.1.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të biznesit.

## 2.2. Politika të rëndësishme kontabël

### 2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

### 2.2.2 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

#### Të arkëtueshmet tregtare

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmive objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

Në fund të cdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

## **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A**

### **Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

#### **2.2.3 Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera**

Në llogarinë e parapagimeve dhe të arkëtueshmeve tjera përfshihen parapagimet dhe pasuritë e tjera qarkulluese. Parapagimet mbahen me kosto minus provizioni nëse ka. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti.

#### **2.2.4 Llogaritë e pagueshme dhe akrualet**

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë. Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes.

#### **2.2.5 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i kompanisë njihet me vlerë nominale.

#### **2.2.6 Fitimet e mbajtura**

Fitimet e mbajtura përbëhen nga fitimet e pashpërndara të kompanisë nga vitet paraprake si dhe fitimi aktual.

#### **2.2.7 Njohja e te hyrave**

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për produktet e shitura apo shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, neto nga kthimet e klientëve, zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

**Shitjet e shërbimeve** – Këto të hyra njihen në periudhën kontabël në të cilën ofrohen shërbimet.

#### **2.2.8 Tatimi ne fitim**

Kompania i nënshtrohet ligjit NR. 06/L -105 për Tatimin në të ardhurat e Korporatave. Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit.

#### **2.2.9 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse me metodën e interesit efektiv.

# NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

## Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

### 3 ADAPTIMI I STANDARTEVE TË RISHIKUARA DHE STANDARDEVE TË REJA

Pasqyrat financiare të Kompanisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### 3.1 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet efektive në këtë periudhë

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNK 1 dhe Deklarata e praktikës së SNRF 2	Shpalosja e politikave të kontabilitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF Deklarata e praktikës 2)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNRF 17	Kontratat e sigurimit (Ndryshimet ne SNRF 17)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 12	Tatimi i shtyrë në lidhje me pasurit dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNRF 17	Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 – Informacion krahasues (Ndryshimet në SNRF 17)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 8	Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 16	Prona, Impiantet dhe Pajisjet — Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 37	Kontratat e mëdha - Kostoja e Përbushjes së Kontratës (Ndryshimet në SNK 37 )	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2022
SNRF 3	Referenca në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2022
SNRF 16	Covid-19- Koncesionet e qirave të lidhura pas 30 Qershor 2021 (Ndryshimet në SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 prill 2021
SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16	Reforma e standardit të normës së interes – Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2021

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

SNRF 16	Covid-19- Koncesionet e qirave të lidhura (Ndryshimet në SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 qershorit 2020
SNK 1 dhe SNK 8	Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
Korniza konceptuale	Ndryshimet në referenca të Korniza konceptuale në standardet e SNRF	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNRF 3	Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNK 28	Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe ndërmarrje të përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
IFRIC 23	Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 9	Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshimet në SNRF 9)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 19	Plani i ndryshimit, mbylljes ose zgjidhjes (Ndryshimet në SNK 19)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 16	Qiratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 1	Përmirësimet vjetore në SNRF të ciklit 2015-2017	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019

## NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

#### 3.2 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet jo efektive në këtë periudhë

Në këto pasqyra financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme akoma nuk janë efektive:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNK 21	Mungesa e shkëmbimit – (Ndryshimet në SNK 21)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2025
SNK 1	Klasifikimi i obligimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Ndryshimet në SNK 1)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 16	Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 1	Detyrimet afatgjata me Konventa (Ndryshimet në SNK 1)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 7	Disclosures: Supplier Finance Arrangements –(Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024

Kompania ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Kompania parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

**4. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË**

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Paraja në bankë	106,702	65,843
Paraja në arkë	232	141
<b>Total paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>106,933</b>	<b>65,984</b>

**5. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE DHE TE TJERA**

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Llogaritë e arkëtueshme	37,074	14,250
Parapagimet ndaj tatimit në fitim	846	-
<b>Total llogaritë e arkëtueshm dhe të tjera</b>	<b>37,921</b>	<b>14,250</b>

**6. LLOGARITË E PAGUESHME DHE AKRUALET**

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Llogaritë e pagueshme	42,420	-
<b>Total llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera</b>	<b>42,420</b>	<b>-</b>

**7. OBLIGIMET TATIMORE**

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Detyrimet ndaj pagave	32,427	18,767
TVSH në shitje	6,398	4,483
Detyrimi ndaj tatimit në paga	2,185	1,132
Detyrimi ndaj kontributeve	3,643	2,102
Obligimet për tatim në fitim vjetor	-	4,381
<b>Total obligimet tatimore</b>	<b>44,653</b>	<b>30,865</b>

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

**8. TË HYRAT NGA SHITJA**

	<b>31 Dhjetor 2023</b>	<b>31 Dhjetor 2022</b>
Të hyrat nga pastrimi dhe mirembajtja e objekteve	280,173	136,349
Të hyrat nga recepcioni	80,100	48,861
Të hyrat nga krasitja dhe mirembajtja e parqeve	65,741	63,460
Të hyrat nga donacionet	33,450	-
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>459,464</b>	<b>248,671</b>

**9. KOSTOJA E MALLRAVE TË SHITURA**

	<b>31 Dhjetor 2023</b>	<b>31 Dhjetor 2022</b>
Kosto e materialit shpenzues operativ	42,087	1,877
Kosto e materialit higjenik/sanitar	2,660	1,175
<b>Totali i kostos së mallit të shitur</b>	<b>44,748</b>	<b>3,052</b>

**10. SHPENZIMET E PERSONELIT**

	<b>31 Dhjetor 2023</b>	<b>31 Dhjetor 2022</b>
Shpenzimet e pagave bruto	338,588	191,204
Kontributet për Sigurim Pensional	16,935	9,547
<b>Totali i shpenzimeve të pagave</b>	<b>355,523</b>	<b>200,751</b>

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

**11. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE**

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Shpenzimet e asetëve të vogla <1K	11,870	-
Shpenzimet e tjera operuese	11,682	-
Shpenzimet për operative	7,403	-
Shpenzimet e derivateve	5,289	364
Shpenzimet profesionale juridike dhe financiare	3,031	-
Shpenzime për lëndime dhe sëmundje të shkaktuara në punë	2,300	-
Shpenzimet e zyrës dhe administratës	1,538	273
Shpenzimet e mirëmbajtjes së zyrës	1,483	20
Shpenzimet komunalive	1,330	-
Shpenzimet e antarsimeve dhe licenca	1,200	100
Shpenzimet e internetit dhe telefonit	628	155
Shpenzimet e provizioneve bankare	469	352
Shpenzimet e automjeteve	207	-
Shpenzimet e kuzhinës (Uji)	176	139
Shpenzimet e reklames dhe reprezentacionit	154	-
Shpenzimet higjienike	116	-
<b>Totali i shpenzimeve administrative</b>	<b>48,876</b>	<b>1,401</b>

**12. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIMIT**

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
<b>Fitimi para tatimit</b>	9,443	43,750
<b>Rregullimet per:</b>		
<i>Korrigjimet per qellime tatimore</i>	874	56
<i>Humbja e bartur tatimore</i>	-	-
<b>Fitimi/Humbja pas korrigjimit</b>	<b>10,317</b>	<b>43,806</b>
 <i>Tatimi ne fitim 10%</i>	 <b>1,032</b>	 <b>4,381</b>
Donacioni - ligji per spnozORIZIM	-	-
Tatimi ne fitim i paguar	1,878	-
Parapagimi i tatimit ne qira	-	-
<b>(Parapagimi) / Detyrimi per tatim ne korporata</b>	<b>(846)</b>	<b>4,381</b>

## NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

#### 13. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese.

Në lidhje me palët e lidhura, kompania aplikon rregulloren sipas SNK 24 (Shpalosja e palëve të ndërlidhura):

- Palët të cilat në mënyrë direkte apo të tërthortë kontrollojnë ose janë të kontrolluara nga njësi ekonomike;
- Palët për të cilat kompania ka një interes që do të kishte një ndikim të rëndësishëm apo kontroll mbi kompaninë;
- Individët privat të cilët në mënyrë direkte apo indirekte kanë ndikim në vendimmarrjen e kompanisë duke filluar nga punëtorët, menaxhmenti e deri tek drejtorët e kompanisë;
- Kur mirret parasysh cdo transaksion me palët e lidhura, vëmendjen më të madhe e ka përmbajtja e marrëdhënies e jo vetëm forma ligjore.

Një transaksion në mes palëve të lidhura është transferim i burimeve, shërbimeve dhe detyrimeve në mes entitetit raportues dhe palës së lidhur, pavarësisht nëse është ngarkuar çmimi apo jo. Përgjatë vitit 2023 kompania kishte këto transaksione me palët e lidhura:

Llogaria	Përshkrimi i transaksionit	Për vitin që përfundoi me 31 Dhjetor 2023
Llogaritë e arkëtueshme	Komuna e Obiliqit	22,824

#### 14. VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT

##### 14.1 Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare. Menaxhimi i rrezikut të kompanisë përqendrohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të kompanisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga menaxhimi i kompanisë bazuar në disa politika dhe procedura të shkruara të paracaktuara me shkrim që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe fusha specifike, siç janë: rreziku i likuiditetit dhe rreziku i kapitalit.

##### 14.2 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që kompania do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet financiare që lidhen me dhënien e mjeteve monetare ose ndonjë pasurie tjetër financiare. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë si rezultat i financimit të pasurive afatgjata me burime afatshkurtëra. Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza të vazhdueshme në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj në momentin kur ato tejkalojnë afatin/kohën e shlyrjes.

## NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

### Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
<b><i>Pasuritë qarkulluese</i></b>		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	106,933	65,984
Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera	37,921	14,250
<b><i>Gjithsej pasuritë qarkulluese</i></b>	<b>144,854</b>	<b>80,234</b>
<b><i>Detyrimet qarkulluese</i></b>		
Llogaritë e pagueshme	74,847	18,767
Të pagueshmet tjera	12,226	12,098
<b><i>Gjithsej detyrimet qarkulluese</i></b>	<b>87,073</b>	<b>30,865</b>
<b><i>Hapësira e likuiditetit</i></b>	<b>1.66</b>	<b>2.60</b>

#### 14.3 Rreziku i kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj duke siguruar se janë të aftë të vazhdojnë aktivitetin sipas hipotezës së vijimësisë për deri sa maksimizojnë kthimet për pronarin përmes optimizimit të balancës së borxhit dhe pasurive. Struktura e pasurisë së kompanisë përbëhet nga paraja, të arketueshmet, stoqet dhe pasuritë jo-qarkulluese. Struktura e borxhit dhe e kapitalit të kompanisë përbëhet nga borxhet, të cilat përfshijnë huatë dhe ekuiteti i atribueshëm të mbajtësit të ekuitetit, që përbëhet nga kapitali dhe fitimet e mbajtura.

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
<b><i>Raporti i obligimeve:</i></b>		
Gjithsej detyrimet	87,073	30,865
Gjithsej kapitali	57,780	49,368
<b><i>Raporti</i></b>	<b>1.51</b>	<b>0.63</b>

#### 15. VLERA E DREJTE E INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Menaxhmenti i kompanisë konsideron se vlera kontabël e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare janë të regjistruara sipas kostos historike. Menaxhmenti bënë vlerësime të vazhdueshme nëse këto instrumente duhet të provizionohen ose të shlyhen.

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
<b><i>Pasuritë financiare</i></b>		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	106,933	65,984
Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera	37,921	14,250
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b>144,854</b>	<b>80,234</b>
<b><i>Detyrimet financiare</i></b>		
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	74,847	18,767
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b>74,847</b>	<b>18,767</b>

## **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A**

### **Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023**

---

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

#### **16. KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET**

##### **16.1 çështjet ligjore**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023 kompania nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

##### **16.2 Detyrimet tatimore**

Librat e kompanisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme. Legjislacioni tatimor dhe doganor i Kosovës i cili është miratuar ose në thelb i miratuar në fund të periudhës raportuese, është subjekt i interpretimeve të ndryshme kur zbatohet për transaksionet dhe aktivitetet e kompanisë.

Rrjedhimisht, pozicionet tatimore të marra nga menaxhmenti dhe dokumentacioni formal që mbështet pozicionet tatimore mund të kundërshtohen nga autoritetet tatimore.

#### **17. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.